



## Më Mirë Vonë se Kurrë

### Mbi Rritjen e Përgjegjesisë së Institucioneve Nderkombetare në Kosovë

<b>Permbledhje Ekzekutive</b> .....	<b>1</b>
<b>Rekomandime</b> .....	<b>6</b>
Organizatave Nderkombetare me role ne Institucionet e ardhshëme te Kosovës .	6
Për Këshillin e Bashkimit Evropian.....	6
Për shtetet antare të NATO-së dhe qeveritë e tjera që kontribuojne ne prezencen ushtarake nderkombetare.....	6
Për Keshillin e Komisionit Evropian për Parandalimin e Torturës .....	6
Ndaj institucioneve te ardhëshme në Kosovë .....	7
Për Perfaqesuesin Civil Nderkombetar .....	7
Per Misionet e Drejtesise dhe Policise ne Kosove .....	7
Per Prezencen Ushtarake Nderkombetare .....	8
Per Qeverine e Kosoves .....	8
Ndaj Institucioneve qe do vazhdojne te jene ne Kosove.....	9
Per Misionin e OSCE-se ne Kosove .....	9
Per Zyren e Kontaktit te Komisionit te Bashkimit Evropian ne Kosove .....	9
Per Institucionin e Avokatit Popullor .....	9
Ndaj Institucioneve qe do te largohen nga Kosova.....	9
Per Misionin e Kombeve te Bashkuara ne Kosove (UNMIK) .....	9
Per Policine e UNMIK-ut .....	9
Per Qendren e KFOR-it.....	10

## Permbledhje Ekzekutive

2007-a është një vit i jashtëzakonshëm për Kosovën. Mbas tetë vitesh nën kontrollin e OKB-së dhe paqartësisë në lidhjet e saj legale me Serbinë, më së fundi statusi i provincës sic duket është drejt rrugës së zgjidhjes. Kjo zgjidhje do të shoqërohet me një “ndryshim të rojeve” ndërkombetare në Kosovë, ka një rol qëndror për Bashkimin Evropian (EU), sic nënvizon statusi i propozuar nga delegati i OKB-se për Kosovën, Martti Ahtisaari.

Ne asnjë fushe tjetër nuk është me e rëndësishme faktori i indryshimit sesa në fushën e Përgjegjësive. Mbas tetë vjetësh qeverisje në Kosovë, Administrata e Brendshme e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) është duke përballuar atë që mund të quhet vecse një si Krizë e Legjitimitetit.

Një pjesë e kësaj krize reflektohet në zhgënjimin e shumicës së shqiptarëve kosovare mbi progresin e zvarritur për zgjidhjen e statusit, dhe midis serbëve dhe minoriteteve të tjera për dështimin e sigurimit të tyre nga ana e UNMIK-ut. Por mungesa e përgjegjësive midis UNMIK-ut dhe institucioneve të tjera ndërkombetare në Kosovë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në humbjen e besimit të publikut ndaj veprimeve të këtyre institucioneve.

Përgjegjësia – shkalla mbi të cilën një institucion dhe zyrtarët perkates japin llogari për aktet e tyre - është elementi celes për një qeverisje të mirë, sebashku me transparencën e vendim-marrjeve dhe zbatimin e ligjeve. Gjithashtu, përgjegjësia është thelbësore në gezimin e të drejtat njerezore.

Ankesat kundra UNMIK-ut dhe forcave paqëmbajtëse të drejtuara nga NATO-ja (KFOR) përmbajnë veprime të tyre në të cilat janë perdhunuar të drejtat e Pronës Private, akuzime për arrestime të paragjykuara, sjellje kriminale dhe kondukte seksuale, si dhe një seri dështimesh në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve. Megjithatë shqetësimet mbi shfaqjet kriminale dhe shkeljet seksuale nuk janë dhe aq të rralla në operacionet e paqes ndërkombetare, dimensionet e këtyre shqetësimeve në Kosovë reflektojnë dështimin e fuqive-te-tejkaluara të misionit të OKB-se për një

protektoratë nderkombetare, dhe pikerisht ky fakt e thekëson rëndësin e Përgjegjësisë.

Vakumi i Përgjegjësise ne Kosovë u ilustrua hapur në fillim te vitit kur policia e UNMIK-ut u përgjigj me force lethale ndaj nje proteste violente me 10 Shkurt, qe rezultoi me vdekjen e dy protestuesve. Trajtimi i shume-kritikuar i OKB-se theksoi mungesën e mekanizmave të pavarura per përgjegjësine dhe mbikëqyrjen të policise të OKB-se, që ishte e varur në zgjidhje burokratike qe vecese sjellin nje dëmtim të vazhdueshëm te imazhit te institucioneve nderkombetare ne mungese te Përgjegjësise.

Në shikimi e pare, duket sikur ekziston nje mekanizëm i përsosur përgjegjësie në Kosovë. Provinca ka një Institucion Ombudsperson (Avokatit Popullor), një Group Këshilltarësh për të Drejtat Njerëzore, që është e vëzhguar nga Organizata per Sigurim dhe Bashkpunim në Europë (OSCE) misioni në Kosovë, Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut së OKB-se, organizata jo-qeveritare dhe media. Gjithashtu ekziston nji shumëllojshmeri në sistemin e brëndshëmë të UNMIK-ut dhe të KFOR-it. Sidoqofte, në realitet këto mekanizma eksiztuese ose janë shumë të dobëta e te paafta të investigojnë institucionet nderkombetare, ose janë të kufizuara në kompetencat e tyre.

Institucioni I Avokatit Popullor u cvesh nga mandati qe të investigoi ankime kundra UNMIK-ut dhe KFOR-it në 2006-en. Grupi Këshilltar për të Drejtat Njerezore që ishte krijuar për të mbushur kete vacuum pergjegjesie ne anën civile, akoma s'ka filluar punen. Tani s'ekziston asnje mekanizëm për të investiguar KFOR-in. Vezhgimi i misionit nga ana e OSCE-se ka ndihmuar daljen ne drite te problemeve, por rekomandimet e tyre ne pergjithesi vecese injorohen.

Strukturat e brendeshme mbikeqyrese të UNMIK-ut, duke perjashtuar ato te mbikeqyrjes finaciare, ose janë te fjetura, ose jane te papërshtatëshme qe ne rrenje. Komiteti mbi Mbikqyrjen e te Drejtave Njerezore, qe gjoja perbehet nga perfaqesues te rangut te larte ne UNMIK dhe K-FOR, as qe s'është takuar ndonjehere ne vite te tera, ndersa nje Komitet Ankesash i ngritur per te drejtuar akuzat individuale ndaj UNMIK-ut, praktikisht konsideron vetem diskutimet ndaj kontraktoreve te UNMIK-ut.

Me Avokatin e Popullit jashte loje, Pergjegjesia e kufizuar e policies se UNMIK-ut dhe KFOR-it eshte praktikisht e ngjuar. Misioni i OSCE-se, Keshilli Evropian dhe Komiteti i te Drejtave Njerezore, qe te treja kane qene kritikuese ndaj mundesive te kufizuara qe kane ata te cilet ankohen per abuzime ne duart e policise se OKB-se dhe paqembajtesit e NATO-s. Policia e UNMIK-ut dhe personeli i KFOR-it jane te brojtura nga marreveshje imuniteti qe lejojne vendime e veprime vetem nga shteti dergues, the ne pergjethesi vetem mbasi personeli i akuzuar eshte derguar ne shtepi, gje e cila e ben complet te pamundesishme per ankuesin qe te jete ne dijeni te ndonje vendimi (neqoftese ka ndonje te tille) hetimor.

Deri me sot, UNMIK-u dhe NATO kane qene shume te papergjegjshem ndaj kritikes mbi mungesen e Pergjegjesise ne institucionet nderkombetare ne Kosove. Megjithate, prap s'eshte vone per te vepruar. Megjithese UNMIK-u shikon ti kete lare duart nga fundi i 2007-es, akoma ka mundesi per hapa positive, duke perfshire gjithashtu operacionet e groupit keshillues ndaj te Drejtave Njerezore.

Ceshtja e NATO-s eshte akoma dhe me e rendesishme. NATO do te drejtoje prezencen e re nderkombetare, qe ne baze te statusit te propozuar, do te zevendesoje KFOR-in si garanntuesja e vetme per Kosoven. Kje e ben te domosdoshme qe NATO-ua te punoj me shtetet anetare te filloj zhvillimin e rregulave te perbashketa dhe procedurat perbrenda KFOR-it qe te munden te vazhdojne dhe tek pasardhesja e saj.

Urgjenca e domosdoshme per zhvillimin e mekanizmave te Pergjegjesise funksionale eshte e njejte edhe per BE, SHBA-s, dhe qeverite e tjera qe do te formojne ne te ardhemen presencen nderkombetare civile ne Kosove. Elementet civile nen statusin e propozuar permbajne nje representatus civil nderkombetar (ICR)<sup>1</sup> me fuqi ekzekutive te vezhgoje zgjidhjen e procesit, dhe nje polici evropiane dhe mission drejtesie nen kompetencat e direktivave evropiane ndaj mbrojtejes the sigurimit (ESDP) e cila do te permbaje nje kontigjent te madh oficeresh policije nga shtetet e BE, se bashku me gjykatën prokurore.

---

<sup>1</sup> Ne shkallen e sotme planifikuese, ky institucion i ri referohet me shume si Zyra Civile Nderkombetare (ICO)

Statusi i propozuar ka mungesa ne detajet e mekanizmave te Pergjegjshmerise. Propozohet qe ICR-i te krijoj nje mekanizem rishikimi per kontrollin e competencave te saja, por nuk e specifikon se c'far lloi mekanizmi do jete. Propozimi sugjeron qe Gjykata e ardhshme Kushtetuese, me gjashte gjykatesa kombetare dhe tre nderkombetare, duhet te kete juridiksion ndaj ankimeve nga individualet qe ankohen se te drejtat e tyre te garantuara nga Kushtetuta jane shkelur nga autoritet publike.

Kjo tregon se mandata institucionale e Avokatit Public duhet te ngelet e pandryshuar, dhe gjithashtu kerkon qe OSCE-ja ta ruaj prezencen e saj ne Kosove. Propozimi eshte i heshtur ndaj mekanizmave te pergjegjesise mbi policine e BE-se, por propozon per mbajtjen e privilegjeve te KFOR-it dhe imunitet per prezencen ushtarake te udhehequr nga NATO.

Per krijimin e mekanizmave efektive ndaj Pergjegjshmerise ne institucionet e ardhshme nderkombetare, kerkohet tejkalmi i kufizimeve te propozimit Ahtisaari. Gjithashtu kerkohen zgjidhje te drejtperdrejta qe bazohen sa me shume ne strukturat ekzistuse. Prandaj ky raport udhezuese permban si rekomandime themeluse qe dy mekanizmat me te rendesishem te Pergjegjshmerise ne Kosoven e ardhshme - Gjykata Kushtetuese dhe Institucioni i Avokatesise Publike – ju jepet pergjegjshmeria e mbikqyrjes se institucioneve nderkombetare.

Specifikisht, juridiksioni i Gjykates se ardhshme Kushtetuese duhet te zgjerohet qe te siguroje se akuzat e shkeljeve te te drejtave njerezore te mbrojtura nga kushtetuta, nga ana civile nderkombetare apo institucionet ushtarake s'do te kalojne pa u degjuar. Kjo do jete ne perputhje me nje rekomadim te mepareshem te Keshillit Evropian. Institucionit te Avokatit Public gjithashtu duhet ti rivendoset mandati e tij origjinal, qe te kete juridiksion mbi investigimin e ankesave ne lidhje me ICR-n, me misionin e policise se BE-se dhe misionin e Drejtesise, dhe me prezencen ushtarake te udhehequr nga NATO.

Keto dy masa pa dyshim do ta shtojne legjitimitetin e institucioneve nderkombetare ne syte e publikut, duke i nenshtruar nen vezhgimin e institucioneve te pavarura ne

Kosove, dhe ato nga ana e tyre do te fuqizojne mundesine e tyre qe te mbajne perpara pergjegjshmerise qeverine e Kosoves.

NATO duhet te punoje me shtetet anetare qe te krijoj mekanizma me efektive dhe konstante me kordinime te brendeshme. Misionet e policise dhe drejtesise se BE-se duhet te bejne te njejten gje, dhe te ftojne Inspektoriatin e Policise se Kosoves te vezhgoje cdo lloj hetimi te brendshem. OSCE-ja dhe Keshilli i Komiteti Evropian per Parandaljen e Tortures duhet te vazhdojne monitorimin e sistemit ligjor dhe vendet e arrestimeve perkatese. Roli i pavarur i OSCE-se ne te ardhmen e Kosoves duhet ta beje me te lehte shprehjen dhe vetshpalljen e shqetesimeve.

Suksesi i institucioneve te reja nderkombetare ne Kosove do te varet nga mundesia e tyre qe te mbajne legjitimitetin e tyre dhe konfidencen e publikut akome edhe ne rastet e marrjes se vendimeve jo-popullore. Kje do varet nga ato institucione qe do te demostrojne transparence, pergjegjesi dhe respect ndaj rregullave ligjore.

Konkretisht, zyra e Reprerentatusit Civil Nderkombetar, misioni i policise se BE-se dhe ai i Drejtesise, dhe prezenca ushtarake e udhehequre nga NATO, duhet qe te sigurojne se ato i permbahen standarteve me te larta ndaj te drejttat njerezore, dhe qe akuzat per shkeljet e gabimet do investigohen me vemendje dhe ashtu sic duhet, dhe qe gjithashtu ti vete-nenshtrohen vezhgimeve te pavarura ne juridiksionet e tyre. Duke vepruar keshtu do te shumefishohet mundesia e suksesit ne Kosove duke sherbyer si nje model shembullor per operacionet e ardhshme paqeruajtese anembane botes.

## Rekomandime

### Organizatave Nderkombetare me role ne Institucionet e ardhshme te Kosovës

#### *Për Këshillin e Bashkimit Evropian*

- Nenshtro misionet e policisë dhe drejtësisë së BE-së nën juridiksionin e Gjykatës së Ardhshme Kushtetuese, në mënyrë të tillë që gjykata të ketë mundësi të degjimit të ankesave ndaj veprimeve të misionit ose agjenteve të saj që mund të kenë shkaktuar shkeljen e të drejtave njerezore që mbrohen nga kushtetuta.
- Nenshtro misionet e policisë dhe drejtësisë së BE-së nën juridiksionin e institucionit të Avokatit Public.

#### *Për shtetet antare të NATO-së dhe qeveritë e tjera që kontribuojnë në prezencën ushtarake nderkombetare*

- Te hyhet në marrëveshje të dyanëshme me qeverinë e Kosovës, duke pranuar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese për të drejtat njerezore mbi forcat e pozicionuara në Kosovë, për të pasur mundësi të degjimit të ankesave ndaj veprimeve të anetarëve të IMP-së ose agjentëve të tyre që mund të kenë shkaktuar shkeljen e të drejtave njerezore që mbrohen nga kushtetuta.
- Te hyhet në marrëveshje të dyanëshme me qeverinë e Kosovës, duke pranuar juridiksionin e institucionit të Avokatit Public mbi forcat e pozicionuara në Kosovë.
- Te bashkepunohet me Qendrën e Prezencës Ushtarake Nderkombetare (IMP) për të themeluar mekanizma standarte për t'ju përgjigju ankesave individuale, si edhe një arkive qendrore informacioni për keto ankesa.

#### *Për Këshillin e Komisionit Evropian për Parandalimin e Torturës*

- Të vazhdohet monitorimi i qendrave të arrestimit në Kosovë, duke përfshirë ato që do të jenë nën juridiksionin e ardhshëm operativ të IMP-së dhe ESDP-së.

## **Ndaj institucioneve te ardhëshme në Kosovë**

### *Për Perfaqesuesin Civil Nderkombetar*

- Në konsultim me Grupin Nderkombetar për Orientim, të nenshtrohet zyra e Perfaqesuesit Civil Nderkombetar nën juridiksionin e Gjykates se ardhshme Kushtetuese për të drejtat njerezore, dhe të mbeshtetet zgjerimi i juridiksionit se gjykatës mbi misionet e policisë dhe drejtësisë se BE-se, dhe gjithashtu tek shtetet pjesemarrese në Preszncën Ushtarake Nderkombetare.
- Në konsultim me Grupin Nderkombetar për Orientim, të nenshtrohet zyra e Perfaqesuesit Civil Nderkombetar nën juridiksionin e institucionit te Avokatit Public, dhe te mbeshtetet zgjerimi i juridiksionit se atij institucioni mbi misionet e policisë dhe drejtësisë se BE-se dhe shtetet pjesemarrese në Prezencen Ushtarake Nderkombetare.
- Të krijohet në konsultim me Komisionin e Venecias së Keshillit Evropian, mekanizma me kompetenca te mjaftueshme kompetente qe lejojnë aketat personale kundra personelit nderkombetar dhe c’do shkelje te lartepemendur.
- Te bashkepunohet per te krijuar kontakte me organizatat nderkombetare per te drejtat njerezore dhe mekanizma jo-qeveritare.
- Te investigohet the shtjellohet ne kohen e duhur c’do ankese individuale e drejtuar direct ose jo ndaj ICR-it.
- Te komunikohet ne kohen e duhur c’do gje ne lidhje me ankesat individuale.

### *Per Misionet e Drejtesise dhe Policise ne Kosove*

- Zyrtarisht, te ftohet Inspectorati i Policise se Kosoves per te pare te gjitha investigimet e brendeshme.
- Te krijohet nje mekanizem kontrolli perbrenda misionit per mbajtjen e ankesave ne Kosove me informacion mbi investigimet ndaj oficerave te policise mbasi ata jane derguar andej nga erdhen, dhe gjithashtu te letesohet bashkepunim i vazhdueshem me investigimet ne Kosove.
- Te harmonizohen proceset operative dhe paisjet e te gjith kontigjenteve policore.



- Te permbliidhen rregulla te qarta per operacionet speciale dhe perdorimin e forces ne kontrollin e situatave ne demonstrata, ne perputhje me standartet nderkombetare mbi perdorimin e forces nga oficeret e ruajtjes se rendid.
- Te vendosen mekanizma kontrrolli nderkombtare transparente dhe te mjaftueshme per policine.
- Te ngrihet dijenia publike mbi ekzistencen e mekanizmave kontrolluese dhe kanalet perkatese ndaj ankesve mbi shkeljet e te drejtave njerezore.
- Te investigohen ankesat individuale dhe te raportohen ne kohen e duhur tek te ankuarit.
- Te sigurohet levizja e Komitetit te Parandalimit te Torturave neper te gjitha vendqendrimet e te arrestuarve, dhe gjithashtu te njoftohet per publikimin e c'do raporti te leshuar nga Komiteti per Kosoven.

#### *Per Prezencen Ushtarake Nderkombetare*

- Te hartohen marreveshje me kombet kontribuese te trupave, qe te ngrihen mekanizma standarte ne lidhje me ankesat individuale.
- Te vendoset nje arkive centrale infromacioni per te gjitha ankesat e referuara dhe te parandalohet nderprerja e hetimeve per shkak transferimi te trupave.
- Te sigurohet levizja e lire e Komitetit per parandalimin e Torturave ne te gjitha burgjet dhe dijeni tek te gjitha publikimet e raporteve qe do dalin si vijim.

#### *Per Qeverine e Kosoves*

- Te merren hapa per inkurajimin e zgjerimit te juridiksionit te Gjykates Kushtetuese nen Zyren e Perfaqesuesit Civil Nderkombetar dhe misioneve te Drejtesise dhe Policise evropiane. Te inkurajohen shtetet pjesemarrese ne Prezencen Ushtarake Nderkombetare, qe te hyjne ne marreveshje dypaleshe me qeverine e Kosoves per te pranuar juridiksionin e Gjykates Kushtetuese mbi forcat e pozicionuara ne Kosove.
- Te mbeshtetet rivendosja e juridiksionit per institucionin e Avokatit Popullor, mbi investigimin e ankesave kundra institucioneve nderkombetare civile e ushtarake.

- Te sigurohet levizja e Komitetit te Parandalimit te Torturave neper te gjitha vendqendrimet e te arrestuarve, dhe gjithashtu te njoftohet per publikimin e c'do raporti te leshuar nga Komiteti per Kosoven.

## **Ndaj Institucioneve qe do vazhdojne te jene ne Kosove**

### *Per Misionin e OSCE-se ne Kosove*

- Te vezhgohet sistematikisht forca e ardhshme ushtarake ne Kosove, dhe ne vecanti roli i saj ne systemin e kriminalistikes dhe te publikohen rezultatet.

### *Per Zyren e Kontaktit te Komisionit te Bashkimit Evropian ne Kosove*

- Te shikohet me nje sy kritikal qendrimi ndaj te drejtave njerezore i aktoreve nderkombetare civilian apo ushtarake kudo qe gjenden ne Kosove, dhe gjithashtu te vezhgohet Kosova me mekanizma stabilizimi dhe krahasimi te proceseve investiguese (STM).

### *Per Institucionin e Avokatit Popullor*

- Me kujdes te investigohen te gjitha akuzat e abuzave te te drejtave njerezore kundra institucioneve kombetare dhe atyre nderkombetare qe do kene mandatin dhe te behen publike te gjitha rezultatet e investigimeve.

## **Ndaj Institucioneve qe do te largohen nga Kosova**

### *Per Misionin e Kombeve te Bashkuara ne Kosove (UNMIK)*

- Menjehere te aktivizohet trupi Keshillues i te drejtave njerezore.
- Publikisht dhe ne kohen e duhur ti pergjigjet c'do akuze te te drejtave njerezore te shkaktuar direkt apo indirekt nga aktiviteti i UNMIK-ut.
- Te njoftohen e publikohen raportet nga Komiteti per Parandalimin e Torturave.

### *Per Policine e UNMIK-ut*

- Te vendosen procedura standarte per kontroll duke e paisur Inspektoriatin e Policise se Kosoves me nje mandat zyrtar mbi vezhgimin e investigimeve te brendshme perbrenda UNMIK-ut.

- Te permbliidhen rregulla te qarta per operacionet speciale dhe perdorimin e forces ne kontrollin e situatave ne demonstrata, ne perputhje me standartet nderkombetare mbi perdorimin e forces nga oficeret e ruajtjes se rendid.
- Te investigohet the shtjellohet ne kohen e duhur c’do akuze mbi abuzat e policies, duke perfshire ndjekjen e procesit ne rastet kur policet e akuzuar ose fajtor kthehen ne vendet e tyre, dhe gjithashtu te publikohen rezultatet e investigimeve.
- Te pergjigjet ne nje menyre te sakte dhe ne kohen e duhur te gjitha pyetjeve te publikut ne lidhje me abuzimet policore.
- Te merren the gjitha hapat e duhura per indetifikimin e c’do pergjegjsie individuale mbi aktet kriminale nga ana e policeve te UNMIK-ut dhe eproreve te tyre qe kane pasur pjese ne plagosjet dhe vdekjet e protestuesve me 10 Shkurt te 2007-s. Gjithashtu, te kompesohen viktimat dhe familjet e tyre dhe te publikohen rezultatet dhe perfundimet e investigimit si nje ceshtje komletesisht te plotesuar.

#### *Per Qendren e KFOR-it*

- Te vendosen marreveshje me shtetet kontribuese per ngritjen e mekanizmave standarte per investigimin e ankesave kundra KFOR-it, dhe te sigurohen standarte unike per investigimet, persekutimet dhe kompesimet.
- Te vendosen groupe kontakti e vezhgimi si ndermjetes per ceshtjet e ankesave nga ana e publikut.
- Te vendoset nje arkive qendrore informacioni per sigurimin e ndjekjes sistematike te ankesave ne menyre te sakte dhe me kujdes ndaj ceshtjeve kur paqeruajtesit jane derguar ne vendet e tyre.
- Te informohen sic duhet te ankuarit ne lidhje me rezultatet e investigimeve.
- Te vihet ne dijeni dhe te publikohet c’do raport i mbajtur nga ana e Komitetit per Parandalimin e Torturave ne Kosove.